



RREGULLORJA E BREND SHME E SHKOLLËS



**KOLEGJI
“TURGUT ÖZAL”**

KOLEGJI “ TURGUT ÖZAL ”

Udhëzues dhe rregullore e brendshme e shkollës
për kërkesat e përgjithshme të ciklit parashkollor
dhe shkollës 9-vjeçare.

Turgut Özal Education Sh.A. Drejtoria e Përgjithshme
Rr. "Pavarsia", Autostrada Tiranë-Durrës, Km 1
Tel: +355 4 223 47 16

Kopshti "Zübeyde Hanım" Tiranë
Rruga Bernardin Palja, Ndërtesa 15, Tiranë
Tel: +355 42 486-666

Shkolla 9-vjeçare " Turgut Özal" Tiranë
Rruga Bernardin Palja, Ndërtesa 15, Tiranë
Tel: +355 42 486-666

PËRMBAJTJA

Misioni, vizioni, përparësitë, historiku i shkollës sonë	5
Sistemi ynë arsimor	8
Çfarë presim ne nga prindërit	12
Çfarë presim ne nga nxënësit	16
Rregullorja e brendshme e shkollës	18
Rregullat e frekuentimit	20
Rregullat e klasës dhe mësimi	22
Kendveshtrim i përgjithshëm mbi rregullat e shkolles	27
Rregullat e veshjes	30
Rregullat e mensës dhe kafeterisë	32
Rregullat e bibliotekës	33
Rregullat e internetit	34
Rregullat e infermierisë dhe të mjekut	35
Rregullat e sallës së konferencave, multimedias dhe kinemasë, kls 3d, dramës, ipad etj.	36
Rregullat e vizitorëve	37
Rregullat e servisit	40
Disiplina	43
Rregullat e pranimi dhe regjistrimit pranë shkollës “turgut özal”	50
Veprimtaritë e parashikuara në kalendarin akademik	51
Klubet që do të zhvillohen gjatë vitit akademik:	55
Përgatitjet për olimpiadat që do të zhvillohen gjatë vitit akademik:	56
Shëtitjet që do të zhvillohen gjatë vitit akademik:	56
Disa provime të rëndësishme që do të zhvillohen gjatë vitit akademik:	57

Misioni, vizioni dhe
përparësitë e shkollës sonë

MISIONI, VIZIONI DHE PËRPARËSITË E SHKOLLËS SONË

Misioni ynë

Ne synojmë që nxënësit tanë të mësojnë duke kaluar pengesat e të mësuarit mekanik, dhe që njohuritë e përftuara të gjejnë përdorim jo vetëm në testime, por gjithashtu të shërbejnë si një urë lidhëse me të menduarit kritik në fusha të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe artet dhe sportin. Rëndësi të veçantë i kushtojmë kultivimit të mendimit të lirë dhe lirshmërisë së shprehjes, duke qenë të hapur ndaj vlerave universale. Duam që nxënësit tanë të priren për të mësuar gjatë gjithë jetës, të jenë të aftë të kryejnë studime shkencore si dhe të kenë nivele të larta në gjuhë të huaja dhe komunikim. Gjithashtu synojmë që këta fëmijë të kenë aftësinë të punojnë në mënyrë të pavarur, duke qenë njëkohësisht pjesëtarë aktivë dhe të përgjegjshëm të komunitetit ku bëjnë pjesë. Në një suazë më të gjerë, institucioni ynë arsimor synon që të prodhojë një qytetar të botës, i cili, duke njohur shumëllojshmërinë e njerëzve, të jetë sa i ndjeshëm, tolerant e altruist me të tjerët, po aq edhe me vetëbesim, kërkues e ambicioz për të ngjitur shkallët e një karriere të projektuar me një target të qartë.

Vizion ndërkombëtar

Institucioni ynë synon të përgatisë individë me vizion ndërkombëtar. Ne ndjekim nga afër ndryshimet globale dhe, për të përgatitur nxënës me standarde ndërkombëtare, kemi krijuar vizionin tonë ndërkombëtar. Në përputhje me këtë vizion, ofrojmë arsimim të klasit botëror. Praktikimi i teknologjive arsimore të përdorura gjerësisht në Europë e SHBA, mundëson një mësimdhënie të denjë për t'u vlerësuar jo vetëm në Shqipëri, por në mbarë botën. Suksesi i këtyre metodave vërtetohet nga arritjet e nxënësve tanë në projekte, olimpiada dhe konkurse të ndryshme ndërkombëtare. Në përfundim të ciklit të mesëm, nxënësit tanë e ndjejnë veten lehtësisht të integruar në universitete të suksesshme kudo nëpër botë.

Përparësitë e institucionit tonë arsimor

Ne jemi të vendosur të arrijmë majat e cilësisë në mësimdhënie. Çdo hap i yni planifikohet në mënyrë të detajuar dhe ndiqet me rigorozitet nga personat përgjegjës. Institucioni ynë kujdeset që stafi pedagogjik të trajnohet me metoda që bazohen në teknologjinë dhe mësimdhënien më bashkëkohore, me objektivin për t'u dhënë më të mirën nxënësve tanë. Disa komponentë të rëndësishëm për realizimin e këtij qëllimi janë smartboard-et në çdo klasë, mësimi me ipad, laboratorët e lëndëve shkencore, sallat e mësimi me projeksion tre dimensional, ambientet sportive, artistike dhe letrare, si dhe klubet e ndryshme përmes të cilëve fëmijët socializohen mes tyre. Epërsi tjetër e jona është edhe lënda e anglishtes me të

cilën fëmijët njihen që në kopsht dhe e perfeksionojnë përgjatë viteve shkollore me një fjalor të pasur edhe të lëndëve shken-core, të praktikuara që prej fillesave tona në gjuhë të huaj. Zëri i nxënësve shprehet nga senati, ndërsa hapat e nevojshëm për plotësimin e kërkesave ndërmerren nga drejtuesit e përku-shtuar të shkollës sonë. Rëndësi të veçantë merr mbështetja e mësuesve kujdestarë, mësuesve këshillues, psikologut dhe ekspertëve në zhvillimin e këtyre grupmoshave. Përgjegjë-sia është vlerë që u mësohet nxënësve tanë që në moshë të hershme dhe suksesi i arritjeve në këtë pikë mbikëqyret nga komisione të veçanta etike, disipline dhe vlerësimi.

Historiku i shkollës sonë

Orët e para mësimore në shkollat “Turgut Özal”, u zhvilluan në vitin 1995, në Tiranë. Fillimisht, nxënësit tanë frekuentonin këto institucione arsimore në ambiente të marra me qira në zona të ndryshme të qytetit, derisa në shtatorin e vitit 2004, u ngrit kompleksi “Turgut Özal”, i pari kompleks arsimor privat i ngritur në Shqipëri, i cili hapi dyert e tij për qindra nxënës të arsimit parashkollor, 9-vjeçar dhe atij të mesëm. Tashmë aktiviteti ynë arsimor filloi të ndjekë rrjedhën e tij në mjediset e një shkolle të plotësuar në çdo aspekt me kushtet më bashkëkohore të mësimdhënies, ku nxënësit marrin ar-simimin përkatës, duke nisur nga cikli parashkollor e deri në maturim. Ritmet e shpejta të rritjes së numrit të nxënësve sollën kërkesën për ambiente të reja dhe si rrjedhojë, në vitin 2014, shkolla e mesme “Turgut Özal”, u transferua në një go-dinë të re, e lokalizuar kjo në hyrje të qytetit të Tiranës. Në kompleksin “Turgut Özal”, çdo vit arsimor studiojnë rreth 1700 nxënës.

Sistemi ynë arsimor

SISTEMI ARSIMOR-EDUKATIV

Cikli parashkollor

Në kompleksin tonë ofrohet një arsim modern edhe në kopsht, në krye të së cilit është vendosur një staf me përgatitje bashkëkohore. Ambientet tona komode dhe tepër higjienike, me facilitete në të cilat nxënësit ndihen të plotësuar fizikisht dhe emocionalisht, i stimulojnë nxënësit të jenë pjesëmarrës aktivë në çdo veprimtari. Programi i miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë i zbatuar dhe pasuruar në këto ambiente si dhe bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin e bëjnë përvojën e nxënësve në kopshtin tonë një kënaqësi që nxit nxënien dhe edukimin e tyre.

Arsimi parashkollor në Kolegjin “Turgut Özal” fillon në moshën tre vjeç. Krahas çdo edukatoreje për grup, fëmijëve u jepen mësimet kompjuteri, anglishteje, aerobie, teatri, edukim të vlerave qytetare dhe muzike nga mësues të tjerë.

Cikli nëntëvjeçar

Shkolla jonë 9-vjeçare, me stafin me përvojë në arsim, me sistemin arsimor dhe kulturën institucionale të konfirmuar, është lider në fushën e arsimit.

Fillimi dhe mbarimi i vitit shkollor dhe të gjitha pushimet përgjatë vitit shkollor, janë të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe zbatohen si në shkollat e tjera publike.

Mësimi i gjuhës angleze dhe i kompjuterit fillon në institucionet tona arsimore qysh në kopsht. Me kalimin e viteve, orët e mësimi ndryshojnë, dhe në fund të klasës së 9-të, nxënësit tanë kanë të paktën nivelin upper-intermediate në anglisht dhe njohuri e praktikë më se të mjaftueshme në kompjuter.

Në shkollën tonë, gjatë orarit të leximit, një orë e veçantë në mëngjes para se të nisë mësimi, nxënësit pasurojnë botën e tyre duke lexuar klasikët botërorë dhe librat më të zgjedhur të letërsisë shqiptare, që pasqyrojnë vlerat më të larta njerëzore. Klasa me projeksion 3D, Klasa me iPad, Klasa e robotikës, Palestra me përmasa olimpike, Kuzhina e klubit të gatimit, Kabineti i Muzikës, Anglishtes, Turqishtes, Teatrit, Vizatimit, Aftësimi Teknologjik, Laboratori i Diturisë së Natyrës, Kompjuterit, Biologjisë, Kimisë, Klasa e Testimeve online, Libraria, Sallonet e Aerobisë dhe Kinemasë, Salla e madhe e Konferencave janë ambiente të ndryshme të përgatitura për grupmosha të ndryshme. Studimi i lëndëve të ndryshme në ambiente të ndryshme është metoda më bashkëkohore e mësimdhënies dhe bën që këto lëndë të mësohen me efikasitet të lartë. Duke filluar nga klasa e 7-të, nxënësve u mësohet turqishtja si gjuhë e dytë e huaj me anë të mësuesve të huaj e vendas që aplikojnë metoda, aktivitete dhe programe të ndryshme në tabela inteligjente, duke u mundësuar nxënësve një përvetësim të shpejtë të kësaj gjuhe.

Për të motivuar nxënësit me prirje në lëndë të caktuara, shkolla organizon olimpiada dhe konkurse shkencore. EPOKA-Cogito Science Olympiad dhe ASEF (Albanian Science and Engineering Fair) janë produkte të institucioneve arsimore “Turgut Özal”, ku çdo vit bëhen pjesë qindra nxënës të dalluar. Njëkohësisht, nxënësve më të suksesshëm u mundësohet pjesëmarrja në olimpiada të së njëjtës natyrë por në rang ndërkombëtar.

Aktivitetet jashtëshkollore ndihmojnë nxënësit në zhvillimin e aftësive dhe prirjeve të tyre, prandaj në institucionin tonë ka një mori klubesh si Klubi i Gatimit, Robotikës, Sporteve të ndryshme (hendboll, basketboll, futboll, volejboll), Muzikës (piano, kitarë, violinë), Art Pamor (vizatim, ebru) Modë dhe Stilim, Arti Skenik (Folklor, teatër, prezantim), Fotografi, Media dhe Gazetari. Lojrat e inteligjencës janë një nga metodat që përdorim për të nxitur mendimin kritik dhe ndërtimin e strategjive për të arritur suksesin. Hanoi, Shah, Jenga, 9-Gurësh janë disa prej tyre.

Aftësia e punës në skuadër dhe bashkëpunimi për arritjen e objektivave dhe rezultateve të larta në konkurse mbetet qëllim i shkollës sonë. Konkursi i Artit dhe Letërsisë (këngë, recitim, vizatim, hartim, teatër) si dhe konkurset e shumta që zhvillohen gjatë javëve të lëndëve të ndryshme janë disa mjete që përdoren për nxitjen e këtyre vlerave. Në fund të çdo viti shkollor nxënësit shfaqin aftësitë e përvetësuara tek festat e klasave.

Mësimi nëpërmjet veprimtarive artistike të aftësive të nevojshme për shekullin e ri, siç është të folurit para publikut, bëhet edhe më i thjeshtë në ambientet e sallës së madhe të konferencave ku zhvillohen rreth 80 programe në vit.

Çfarë presim ne nga prindërit

ÇFARË PRESIM NE NGA PRINDËRIT

1. Prindërit duhet të nxisin frymën pozitive te fëmijët në lidhje me shkollën dhe rëndësinë e respektit ndaj mësimeve dhe mësuesve. Mungesa e një fryme të tillë dekurajon dashurinë e fëmijëve ndaj arsimit.

2. Sistemi ynë arsimor ngrihet mbi bazën e bashkëpunimit prind-mësues. Është përgjegjësi e çdo prindi të përfshihet në jetën shkollë të fëmijës. Është vërejtur se fëmijët, prindërit e të cilëve nuk paraqiten në shkollë, janë më të ndrojtur, me më pak vetëbesim dhe me rezultate më të ulëta se potenciali i tyre. Në disa raste të tilla nxënësit nuk i përmbahen rregullores, ndaj ju këshillojmë të vini sa më shpesh në shkollë për t'u takuar me stafin e shkollës.

3. Prindërit duhet të takohen me mësuesit në oraret e përcaktuara, me qëllim që takimi të jetë sa më i frytshëm dhe mësuesi t'u kushtojë sa më shumë kohë cilësore prindërve.

4. Ndhmoni dhe nxiteni fëmijën tuaj të zbatojë rregulloren e brendshme të shkollës. Kjo do të ndikojë në përfitim të konceptit të disiplinës dhe rregullsisë tek fëmija juaj.

5. Ndhmohini fëmijët me detyrat e shtëpisë. Punoni rregullisht mbrëmjeve me ta dhe mësojuni të jenë sistematikë (klasat 1-2-3). Nëse fëmija është më i madh, kontrolloni detyrat.

6. Plotësimi i çdo kërkesë që paraqitet nga fëmija juaj mund të ndikojë negativisht në formimin e tij.

7. Mos i dërgoni fëmijët në shkollë me celularë apo pajisje elektronike që mund të largojnë vëmendjen e tyre prej mësimeve.

8. Tregoni kujdes me sasinë e parave që u jepni fëmijëve me vete.

9. Kontrolloni në mëngjes nëse fëmija juaj ka veshur uniformën e duhur sipas orarit mësimor.

10. Veprimi midis bashkëshortëve me të njëjtin qëndrim, është tepër i rëndësishëm në edukimin e ekuilibruar të fëmijës, ndaj prindërit duhet t'i marrin bashkërisht vendimet dhe t'i zbatojnë ato.

11. Në rastet kur fëmijën vjen ta vizitojë dikush tjetër përveç prindërve, ai duhet t'i prezantohet shkollës nëpërmjet prindërve sipas përcaktimeve të rregullores së brendshme të shkollës.

12. Informacion rreth nxënësit do t'i jepet vetëm prindërve dhe askujt tjetër.

13. Ndryshimet e adresës dhe numrit të telefonit duhet t'i përcillen drejtorisë së shkollës pa u vonuar.

14. Drejtoria e shkollës nuk mban përgjegjësi për asnjë aktivitet të organizuar nga persona jashtë shkollës apo nga nxënës të shkollës.

15. Prindërit duhet të jenë të kujdesshëm për aktivitetet joshkolllore ku lejojnë të marrin pjesë fëmijët. Është e rëndësishme që fëmijët të mbrohen nga ambientet ku mund të shfaqen vese dhe sjellje të dëmshme.

16. Kontrolli i përdorimit të internetit nga nxënësit vetëm për qëllime mësimi dhe komunikimi do t'i ndihmojë ata të ruhen nga gjëra të dëmshme.

17. Prindërit duhet të firmosin dokumentet që u dorëzohen me qëllim informimi mbi gjendjen e nxënësve dhe t'i kthejnë në drejtorinë e shkollës për një mbarëvajtje sa më të mirë të fëmijëve në mësim.

18. Në rastet kur hasen probleme mësimesh apo disiplinore, për një zgjidhje sa më të shpejtë dhe efikase, preferohet që në vend të telefonit të bisedohet ballë për ballë me drejtorin apo mësuesin përkatës.

Çfarë presim ne nga nxënësit

ÇFARË PRESIM NE NGA NXËNËSIT

1. Duhet të vini në orar në mësim, të futeni në klasë pa rënë ende zilja dhe të prisni mësuesin. Nëse futeni në mësim pas hyrjes së mësuesit, do të shkaktoni ndërprerjen dhe vonesën e mësimin për disa minuta, duke u bërë pengesë për të tjerët.
2. Merrni me vete në mësim mjetet e duhura për të ndjekur dhe kuptuar sa më mirë mësimin. Mjetet mësimore ndryshojnë sipas lëndës (libra, fletore, lapsa, bojra, projekte etj.).
3. Duhet të vini të përgatitur në mësim. Kur përgatiteni para se të vini në mësim, do ta keni më të lehtë të kuptoni atë që do të shpjegojë mësuesi në klasë.
4. Duhet të dëgjoni me vëmendje mësimin dhe të merrni pjesë në diskutimet që zhvillohen në klasë. Këta nxënës përfitojnë më shumë nga mësimi.
5. Mësuesit tuaj ju mirëpresin të bisedoni edhe në pushimet midis orëve për çështje që s'i keni kuptuar gjatë mësimin dhe t'ju japin mësim shtesë.
6. Duhet t'i kryeni në mënyrë të plotë detyrat që ju jepen dhe duhet t'i kryeni individualisht me qëllim që ta përvetësoni sa më mirë mësimin. Kopjimi dhe mundësimi i kopjimit është i ndaluar.
7. Synimet kryesore të nxënësit në vitet shkollore duhet të jenë arsimimi dhe edukimi. Nëse e nxisni veten drejt dashurisë për këto të dyja, ato do t'ju shoqërojnë gjithë jetën dhe do jenë ndihma kryesore drejt suksesit.
8. Duhet të njihni dhe zbatoni vlerat e shoqërisë. Mbroni të drejtat e të tjerëve ashtu si mbroni dhe të drejtat tuaja.
9. Si prindërit ashtu dhe mësuesit e shkollës suaj presin që të jeni shembull i mirë dhe model për t'u ndjekur nga të gjithë.

Rregullorja e brendshme e shkollës

RREGULLORJA E BRENDSHME E SHKOLLËS

Është hartuar duke patur si bazë dispozitat normative për arsimim parauniversitar të MASR si dhe specifikën e veprimtarisë së kolegjit “Turgut Özal”.

Drejtoria e shkollës ka të drejtën të shtojë rregulla sipas nevojës për menaxhimin sa më të mirë të procesit mësimor dhe edukativ duke iu përshtatur zhvillimeve sociale, kulturore, teknologjike etj.

QËLLIMET

Pika 1

Qëllimi i kësaj rregulloreje është vendosja e bazave disiplinore në mjediset e shkollës.

Pika 2

Kjo rregullore është hartuar për të përcaktuar detyrimet dhe rregullat që duhet të zbatojnë nxënësit në ambientet e shkollës 9-vjeçare. Ajo është përgatitur me qëllim përcaktimin e masave disiplinore që u jepen nxënësve të cilët e shkelin atë me veprime të papërshtatshme për emrin dhe nderin e fjalës “nxënës”.

Pika 3

Në arsim dhe edukim, koncepti disiplinë nuk do thotë dënim, por rregullim. Disiplinë do të thotë që të arrish të drejtosh nxënësin drejt ndryshimeve pozitive që kërkohen dhe priten prej tyre. Koncepti disiplinë nuk është vetëm një çelës magjik që sjell sukses në mësim, por ai është një udhërrëfyes që e drejton atë gjatë gjithë jetës.

Pika 4

Rregulli themelor i institucionit është të përgatisë një mjedis të përshtatshëm për arsimin dhe edukimin eficient dhe të disiplinuar; krahas dijes t'u japë nxënësve të ndërthurura me edukimin e karaktereve të tyre dhe rregullat e edukatës dhe të mirësjelljes dhe vlera shoqërore, kulturore dhe estetike; të ndajë një hapsirë të konsiderueshme për aktivitete sociale dhe kulturore jashtë shkollore.

RREGULLAT E FREKUENTIMIT

Pjesëmarrja e nxënësve në mësim është e detyrueshme. Nxënësi mund të largohet nga mësimi vetëm në raste urgjente dhe kur kjo kërkesë bëhet prezente nga vetë prindi, i cili për sigurinë e fëmijës tij duhet detyrimisht të jetë ai që ta marrë nga shkolla dhe askush tjetër. Në rastet kur prindi nuk mund të paraqitet për të marrë fëmijën, duhet t'i drejtohet drejtorisë së shkollës me kërkesë me shkrim ku autorizon persona të tjerë për tërheqjen e fëmijës nga shkolla. Kërkesa mund t'i paraqitet vetëm drejtuesve të shkollës.

Duhet të njoftojë drejtorinë e shkollës nëse nxënësi nuk vjen në shkollë. Fletën e justifikimit (kërkesën e prindit) e sjell ditën që paraqitet në shkollë, ndërsa raportin duhet t'ia dorëzojë drejtorisë brenda një jave. Nuk duhet të mungojë kur ka provim. Në qoftë se është sëmurë, duhet që të vihet në dijeni mësuesi dhe të paraqitet për përsëritjen e provimit në datën e caktuar nga drejtoria. Nxënësi që nuk paraqitet edhe në datën e përsëritjes vlerësohet me notën 4.

1. Kur nxënësi i klasave I-III, mungon për një periudhë të vitit mësimor, mësuesi:

- i) zbaton një program individual për nxënësin gjatë kohës që kthehet në shkollë;
- ii) në bashkëpunim me prindërit, hartojnë planin e punës së prindërve me fëmijën gjatë periudhës që fëmija mungon në shkollë dhe gjatë pushimeve verore.

Në fillim të vitit pasues, mësuesi vlerëson arritjen nga nxënësi të objektivave bazë të programeve lëndore të klasës paraardhëse, dhe, sipas rastit, vazhdon me program individual.

2. Nxënësi i klasave IV-IX që mungon më shumë se 35% deri në 50% të orëve mësimore vjetore të një lënde është pakalues në atë lëndë. Përjashtimi është për nxënësit të cilëve shkolla u krijon kushte për mësimin në shtëpi nga mësues të caktuar nga drejtori i shkollës. Këta nxënës, pas kthimit në shkollë, i nënështrohen provimeve për orët e munguara, në data të caktuara nga mësuesi dhe të miratuara nga drejtori i shkollës.

3. Nxënësi i klasave IV-IX, që mungon më shumë se 50% të orëve mësimore vjetore të një lënde, është pakalues në atë lëndë.

4. Nxënësi i shkollës së arsimit të mesëm të ulët, që mungon deri në 35% të orëve mësimore vjetore të një lënde vlerësohet me shkrim nga mësuesi lëndor për ato tema të tekstit shkolllor që ka munguar. Notat e çdo provimi vendosen në shtylla të veçanta të regjistrit dhe i takojnë notave për kapitull (kapitujve) të tekstit të nxënësit. Datat e provimeve caktohen nga mësuesi lëndor në bashkëpunim me prindin e nxënësit dhe miratim të drejtorit të shkollës.

5. Mungesat e nxënësit janë të arsyeshme kur justifikohen me raport mjekësor ose prindi ka kërkuar leje paraprakisht dhe më pas ka paraqitur një shënim sqarues.

6. Prindi e paraqet arsyetimin për mungesat e fëmijës së tij te mësuesi përkatës kujdestar.

RREGULLAT E KLASËS DHE MËSIMIT

1. Klasat duhen mbajtur të rregullta dhe të pastra.

2. Sendet duhen vendosur në dollapet e klasës ose nën banka; mbi bankë nuk duhet mbajtur asgjë e tepërt.

3. Sendet që u përkasin të tjerëve nuk duhen marrë dhe përdorur pa leje.

4. Me të dëgjuar zilen e parë, nxënësit duhet të ndodhen në klasë, gati për mësim.

5. Duhet të keni përgatitur të gjitha mjetet e orës së mësimi para se mësuesi të hyjë në klasë.

6. Sistemi i klasës nuk mund të ndryshohet kurrsesi pa leje. Vetëm në rastet kur drejtorja e shikon të arsyeshme, sistemi brenda klasës mund të ndryshohet.

7. Në klasë nuk flitet me zë lartë e duke bërtitur. Nuk lejohen lojërat (me top, letra etj.) dhe nuk mund të uleni mbi banka.

8. Në rastet kur nxënësi vjen vonë në mësim, duhet të marrë një letër leje nga nëndrejtori dhe pastaj mund të futet në mësim.
9. Nxënësi paraqitet në mësim i përgatitur fizikisht dhe psikologjikisht.
10. Nxënësit paraqiten në mësim me të gjitha mjetet e punës (libra, fletore, laps, stilolaps etj.).
11. Nxënësi gjatë mësimit dëgjon me kujdes mësuesin pa bërë rrëmujë dhe pa shqetësuar të tjerët.
12. Nxënësi është i detyruar t'u përgjigjet pyetjeve të mësuesit
13. Në kohën kur mësuesi bën apelin nxënësit janë të detyruar të përgjigjen.
14. Nxënësi gjatë mësimit duhet të jetë aktiv dhe pjesëmarrës. Nuk duhet të merret me gjëra jashtë mësimit.
15. Të gjithë nxënësit duhet të mbajnë shënime gjatë mësimit. Nxënësit që nuk kanë fletore shkojnë në komision, por para kësaj ndiqen hapa pedagogjikë për ta bindur, ose njoftohet familja e nxënësit dhe i kërkohet që nxënësi të vijë me mjetet e duhura. Është e ndaluar që nxënësi të vijë në çdo mësim me një fletore të re. Fletoren që ka nisur për të mbajtur shënime duhet ta ruajë deri në fund të vitit. Nëse fletorja mbaron, nxënësi nis të re, por ruan edhe të vjetrën. Nëse këtë fletore e humb, atëherë në një fletore të re hedh edhe shënimet e fletores që ka humbur duke i marrë këto nga një nxënës tjetër.
16. Nxënësit duhet të kenë fletore detyrash. Këto fletore nisen në fillim të vitit dhe ruhen deri në fund të tij. Nxënësve u ndalo-

het t'i bëjnë detyrat çdo herë në fletore të ndryshme. Detyrat duhet të gjenden në një fletore të vetme.

17. Nëse nxënësi do t'i bëjë një pyetje mësuesit, duhet patjetër të marrë leje duke ngritur dorën jo në formë të rrëmujshe. Nxënësit nuk lejohet të flasin pa leje dhe të prishin mësimin apo të shqetësojnë të tjerët.

18. Nxënësi nuk mund të çohet pa leje nga vendi i tij.

19. Nxënësi nuk mund të dalë pa leje nga klasa qoftë edhe për në tualet. Në raste urgjente vendimi i takon mësuesit.

20. Në klasë askush nuk mund të fyejë të tjerët, të përdorë fjalë të pahijshme apo të fajësojë dikë për asnjë arsye.

21. Nxënësit nuk mund ta fyejnë mësuesin. Nuk mund t'i kthehen me zë të lartë. Nxënësit janë të detyruar ta shpjegojnë të drejtën e tyre me komunikim të hijshëm.

22. Nxënësi që mendon se i është bërë një padrejtësi bisedon me një gjuhë të përshtatshme me mësuesin kujdestar. Disa probleme bisedohen me nëndrejtorin dhe, nëse nuk mund të zgjidhet me të, kryhet një takim me drejtorin.

23. Nëse nxënësi ka ankesa në lidhje me një nxënësit tjetër apo me një anëtar të personelit, shkruan një ankesë me shkrim ose plotëson një formular në zyrën e nëndrejtorit dhe këtë e dorëzon te mësuesi i paralelit që është anëtari përkatës për komisionin e etikës dhe sjelljes ose te nëndrejtorit përkatës, dhe, si shkalla më e lartë e ankesës, te drejtori i shkollës, gjithnjë duke respektuar radhën e sipërpërmendur.

24. Nxënësit duhet ta mbajnë klasën të rregullt dhe të pastër. Letrat apo mbeturinat nuk duhet t'i hedhin në tokë apo t'i lënë poshtë bankës por t'i hedhin te koshi i mbeturinave.

25. Nxënësit duhet ta mbajnë të rregullt çantën. Nuk u lejohet të marrin çantën e tjetrit dhe të shikojnë brenda saj, të marrin sendet e tjetrit, apo të nxjerrin sendet e tjetrit nga çanta dhe t'i shpërndajnë përreth. Në të kundërt, zbatohet rregullorja disiplinore.

26. Nxënësit nuk duhet të dëmtojnë apo të përvetësojnë sendet e të tjerëve.

27. Nxënësit nuk duhet të dëmtojnë orenditë e shkollës. Për shembull nuk duhet të zhgarravisin bankat apo t'i gërvishtin ato. Nuk duhet të dëmtojnë tavolinën e mësuesit, tabelën inteligjente, tabelat e klasës, muret, dollapet, karriget etj. Në të kundërt, zbatohet rregullorja disiplinore dhe për më tepër nxënësi paguan dëmin e kryer në sasi monetare.

28. Nxënësit e kanë të ndaluar të fusin ushqime në klasë.

29. Nëse me rënien e ziles për fillimin e mësimi nxënësi ka ushqim në dorë, kjo nuk do të thotë që mund të presë te dera e klasës deri sa ta mbarojë. Me rënien e kësaj zileje, nxënësi duhet të jetë brenda në klasë me mjetet e duhura mësimore gati, duke pritur mësuesin.

30. Nxënësit ulen në klasë në bankat që i cakton mësuesi dhe sipas planit të uljes që ky ka përcaktuar.

31. Nxënësit duhet të jenë në klasë me rënien e ziles për nxënësit. Me rënien e ziles së përfundimit të mësimi kanë të drejtë të dalin nga mësimi.

32. Nxënësit nuk duhet t'i lënë çantat, librat, ose sendet e tjera në klasë për një kohë të gjatë. Klasat dhe dollapet në klasë nuk mund të përdoren si depo.

33. Nxënësit nuk duhet të dëmtojnë projektet që gjenden në klasë apo në koridore, qofshin këto të tyre apo të të tjerëve.

34. Nxënësit e kanë të ndaluar në mënyrë kategorike të kopjojnë. Në të kundërt, zbatohet rregullorja disiplinore.

35. Nxënësit nuk kanë të drejtë të pengojnë zhvillimin e mësimi, duke dëmtuar mjetet e nevojshme për këtë punë siç janë tabela inteligjente apo kompjuteri. Në të kundërt, zbatohet rregullorja disiplinore.

36. Nxënësi nuk mund të dalë nga mësimi që po zhvillohet për të marrë leje nga nëndrejtori në rastet kur duhet të largohet nga shkolla. Lejet nga nëndrejtori merren gjatë pushimeve midis orëve.

37. Prindërit nuk kanë të drejtë të marrin nxënësit pasi ora e mësimi ka filluar. Për këtë duhet të presin pushimin midis orëve.

KENDVESHTRIM I PERGJITHSHEM MBI RREGULLAT E SHKOLLES

1. Është e ndaluar që, pa leje, të shkruhet, varet apo të hiqet diçka nga tabelat e njoftimit, posterat, dërrasat e zeza, apo gjithçka e varur nëpër mure, meqenëse ato konsiderohen pronë e shkollës.
2. Me qëllim që të mos prishen rregullat e shkollës dhe të mos cënohen oraret e mësimi, nuk lejohet të luhet me top në oborrin e shkollës (në pushimin e drekës vetëm me lejen e mësuesit të edukimit fizik). Gjithashtu nuk lejohet të silllet topi në klasë pa lejen e mësuesit.
3. Është e ndaluar mbajtja dhe përdorimi i celularëve dhe çdo pajisjeje elektronike. Celularët që gjenden brenda ambienteve të shkollës u merren nxënësve, nxënësve u jepet paralajmërim dhe celularët u kthehen vetëm prindërve. Në raste urgjente, nxënësit mund t'i telefonojnë prindërve nga telefoni i shkollës. Nxënësit duhet të marrin leje për përdorimin e telefonave. Shkolla nuk mban përgjegjësi për telefonat që humbin.
4. Është e ndaluar që nxënësit të sjellin dhe të përdorin në shkollë pajisje elektronike (celularë, ipod, ipad, tablet, kamera, smartwatch etj.). Kur gjenden të tilla pajisje, u merren nxënësve, u jepet paralajmërim dhe u dorëzohen prindërve.
5. Është e ndaluar që të sillen në shkollë dhe të konsumohen nga nxënësit duhan, pije alkoolike dhe të tjera substanca të dëmshme për shëndetin.
6. Nxënësit duhet të sillen me respekt ndaj njëri tjetrit dhe personelit të shkollës. Duhet të ndërtojnë marrëdhënie të mira me shokët dhe t'i respektojnë ata. Nuk duhet të përdorin në asnjë mënyrë fjalë të turpshme, të pahijshme dhe të grinden.

7. Nuk duhet të dëmtoni sendet e shkollës. Në rast dëmtimi, do të jepet dënim sipas rregullave të disiplinës të shkollës dhe do të zhdëmtohet prej vetë nxënësit.
8. Nxënësi duhet të zbatojë rregullat e higjienës dhe pastërtisë në shkollë. Është e ndaluar brenda ambienteve të shkollës ngrënia e farave dhe hedhja e mbeturinave përtokë.
9. Është rreptësisht e ndaluar dalja nga shkolla në oraret e mësimi pa leje nga drejtoria. Gjithashtu nuk duhet shkuar pa leje në laboratorët dhe klasat e tjera. Nga mësimi mund të dilet vetëm me leje nga mësuesi.
10. Nxënësit mund të marrin ushqime nga shtëpia, por është e ndaluar që, pa leje nga drejtoria të porositin ushqim nga jashtë.
11. Ndalohet që nxënësi të ngrejë zërin apo të bëjë zhurmë duke prishur qetësinë në ambientet e shkollës.
12. Ndalohet të sillet në shkollë çfarëdolloj mjeti pa miratimin e mësuesit përkatës apo drejtorit.
13. Ndalohet të sillet dhe të përdoret në shkollë çfarëdo loje bixhozi, mjeti prerës, shpues apo ndezës.
14. Nxënësit s'mund të hyjnë në shkollë me makinat e tyre dhe nuk mund të parkojnë aty.
15. Drejtoria e shkollës mund të bëjë kontroll dollapesh dhe çantash pa lajmëruar nxënësit. Nxënësit që s'pranojnë kontrollin dhe atyre që u gjenden gjëra të ndaluara, dërgohen në Komisionin e Etikës dhe Sjelljes.
16. Në ambientet e shkollës nuk lejohet futja e kafshëve e shpendëve shtëpiake apo të egra që mund të jenë edhe shkas sëmundjesh.
17. Nxënësi duhet t'i përcjellë familjes të gjitha ftesat dhe kërkesat e shkollës.

18. Nxënësi ose prindi duhet të lajmërojë shkollën brenda 15 ditëve për ndryshimet e adresës dhe numrave të telefonit me qëllim që të ketë një komunikim sa më efektiv.

19. Nëse nxënësi nuk mundet të marrë pjesë në ndonjë aktivitet të shkollës, ai ose prindi duhet të bëjë me dije drejtorinë më parë. Nëse nxënësi nuk mundet të hyjë në ndonjë provim me shkrim apo me gojë, duhet sjellë justifikim zyrtar me shkrim brenda tri ditësh.

20. Kur nxënësi vjen në shkollë, duhet të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e shkollës (mësim, ceremoni, studim, provim dhe aktivitete mësimoro-edukative).

21. Nxënësi nuk mund të organizojnë asnjë aktivitet në emër të shkollës pa marrë leje nga drejtoria.

22. Nxënësi duhet t'i kryejë detyrave të dhëna nga shkolla.

23. Nxënësi nuk ka të drejtë të bëjë asnjë ndryshim mbi dokumentet e drejtorisë së shkollës.

24. Nxënësi nuk duhet t'i nxisë të tjerët drejt ndonjë manifestimi të përbashkët.

25. Nxënësi duhet të zbatojë rregullat e përcaktuara nga shkolla.

26. Nuk duhet të bëjë pa leje asnjë lloj aktiviteti brenda shkollës në emër të ndonjë institucioni, grupimi apo partie.

27. Ndalohet sjellja në shkollë e gazetave, revistave, afisheve, fotografive dhe librave me përmbajtje politike dhe të pamoralshme. Nuk duhet të bëhen biseda politike ose ideologjike.

28. Ndalohen sjelljet dhe manifestimet e turpshme.
29. Ndalohen diskriminimi dhe fyerja për shkak të kombësisë, gjuhës, racës, gjinisë, bindjeve politike, fetare etj.
30. Ndalohet mosrespektimi i flamujve dhe simboleve kombëtare të shqipërisë dhe çdo kombi tjetër.
31. Nxënësit nuk duhet të dëmtojnë shokët, personelin e shkollës, t'i kërcënojnë apo t'u ofrojnë gjëra të ndaluara me ligj.

RREGULLAT E VESHJES

1. Është shumë e rëndësishme që uniforma e nxënësve të jetë e thjeshtë, e pastër dhe e hijshme.
2. Ndryshimet e uniformave sipas stinëve vendosen vetëm nga drejtoria e shkollës.
3. Vajzat duhet të veshin uniformën e përcaktuar nga shkolla. Flokët duhet t'i kenë të pastër dhe të krehur. Flokët e gjatë duhen mbledhur ose të bëhen gërshet. Nuk duhet bërë maki-jazh. Thonjtë nuk duhen zgjatur dhe nuk duhet përdorur manikyr. Nuk duhet mbajtur unazë, vëthë, byzylyk, zinxhir apo tjetër bizhuteri zbukuruese. Nuk duhen veshur këpucë me taka të larta e as çizme.
4. Djemtë duhet të veshin uniformën e caktuar nga shkolla. Flokët duhen mbajtur të pastër dhe të shkurtër aq sa të mos e kalojnë qafën. Flokët nuk duhen lyer, nuk duhen prerë “zero”

apo në ndonjë formë të pamiratur nga drejtoria. Flokët nuk duhen bërë gërshet apo mbledhur bisht. Nuk lejohet mbajtja e favoriteve (barsetave), mjekrrës dhe mustaqeve. Nuk duhet mbajtur unazë, zinxhir etj.

5. Duhet treguar kujdes në veshjen e uniformës. Në mësim ndalohet çdo veshje tjetër përveç uniformës së shkollës. Ndalohen këpucët e papërshtatshme.

6. Në lëndën e edukimit fizik dhe aktivitete të ndryshme sportive, duhet veshur uniforma sportive e përcaktuar nga shkolla. Uniforma sportive nuk vishet në mësim të tjera.

7. Nuk është e përshtatshme të bëhet tatuazh dhe është rreptësisht i ndaluar ekspozimi i tij.

8. Ndalohet mbajtja e syzeve dhe lenteve pa raport mjekësor të mjekut.

9. Nuk mund të përdoret asnjë emblemë tjetër (në mënyrë të ekspozuar) përveç asaj së shkollës.

10. Nuk lejohet ndryshimi i formave të uniformës. Nuk mund të ketë rregullime, shkurtime, ngushtime përtej kontureve të përcaktuara nga drejtoria. Uniforma nuk duhet përveshur.

11. Uniforma nuk zëvendësohet me veshje të jashtme. Në rast se nxënësi ka ftohtë, mund të shtojë veshje por vetëm poshtë uniformës së shkollës.

12. Nëse nxënësi në vijimësi shkel rregullat e uniformës, njoftohet prindi se nxënësi nuk do të pranohet në mësim pa uniformën e rregullt.

RREGULLAT E MENSËS DHE KAFETERISË

1. Të gjithë nxënësit duhet të hyjnë në mensë me radhë dhe në orar.
2. Në radhë nuk duhet bërë zhurmë dhe duhen respektuar të tjerët.
3. Nxënësit duhet të hanë ushqimin në tryezën e përcaktuar për ta. S' duhet të shëtisin pa nevojë në mensë dhe duhet të lënë të pastra tryezat pasi të kenë mbaruar së ngrëni.
4. S' duhet folur me zë të lartë në mensë.
5. S' duhet ndryshuar vendi i karrigeve nëpër tryeza.
6. S' duhet nxjerrë ushqim jashtë mensës.
7. Nxënësi duhet të marrë ushqim aq sa mund të konsumojë.
8. S' duhet hyrë në mensë jashtë orarit të ngrënies.
9. Ndalohet hyrja në kuzhinën e mensës.
10. Nxënësi nuk lejohet të kalojë në godinat e tjera për të blerë ushqim. Ndërrimi i godinës lejohet vetëm për të shkuar në mensë. Ndalohet lëvizja në koridoret e ndërtesave të tjera, hyrja në klasa dhe pengimi i punës së personelit në to.
11. Duhet sjellë me edukatë ndaj personelit të mensës dhe nuk duhet debatuar kurrsesi me ta.
12. Ankesat e ndryshme mund të dorëzohen me shkrim te zyra e drejtorit.
13. Në kafeterinë e shkollës, meqë është pjesë e shkollës, janë të vlefshme të gjitha rregullat e mësipërme. Gjithashtu:
 - a) Nxënësi mund të hyjë në kafeterinë e shkollës vetëm në pushim.

- b) Ushqimet dhe pijet që blihet në kafeteri nuk nxirren jashtë saj.
- c) Nxënësit duhet t'i hedhin mbeturinat në kosh.
- d) Ndalohen lojërat e ndryshme si dhe loja me letra brenda kafeterisë.
- e) Ndalohen sjelljet e pahijshme në kafeteri.
- f) Duhet sjellë me edukatë me personelin e kafeterisë.
- g) S'mund të ndryshohet vendi i karrigeve dhe tavolinave pa leje.

RREGULLAT E BIBLIOTEKËS

Lexuesit që përdorin bibliotekën e shkollës përcaktohen në bazë të Nenit 114.

1. Librat e marrë dorëzohen në kohën e duhur.
2. Të gjithë nxënësit mund të marrin libra për llogari të tyre.
3. Nxënësi mund të marrë maksimalisht tre libra në të njëjtën kohë.
4. Në rast se nxënësi dëmton ose humb librin, duhet të blejë një libër me të njëjtin titull dhe ta sjellë në bibliotekë ose ia paguan atë bibliotekës.
5. Duke qenë se biblioteka është pjesë e shkollës, të gjitha rregullat e saj janë të vlefshme edhe në bibliotekë.

RREGULLAT E INTERNETIT

1. Network-u s'mund të përdoret për të instaluar programe pa leje të posaçme.
2. S'duhet përdorur për qëllime tregtie, reklame apo politike.
3. S'duhet përdorur për të dërguar materiale që çënojnë legjislaturën e vendit. Te kjo përfshihet edhe kërcënimi i dikujt apo diçka e ngjashme.
4. Përdoruesit e network-ut s'duhet të përdorin gjuhë të rëndomtë e ofenduese.
5. Përdoruesit s'duhet t'i dërgojnë të tjerëve dosjet personale të tjetërkujt e as ndonjë material shqetësues.
6. Përdoruesit nuk duhet të hyjnë në llogari të të tjerëve apo tek dosjet e tyre personale.
7. Përdoruesit nuk duhet kurrsesi të hyjnë në site, chate apo dhe faqe që përmbajnë foto dhe njohuri amorale apo që janë të ndaluara me ligj. Nëse ndonjë nga përdoruesit përballet me diçka të tillë aksidentalisht, duhet të lajmërojë menjëherë mësuesin ose përgjegjësin e laboratorit.
8. Përdoruesit e laboratorit të kompjuterit duhet t'i fshijnë dosjet e tepërta që zënë shumë vend.
9. Shkolla nuk mban përgjegjësi për dosjet personale të regjistruara.
10. Përdorimi i internetit bëhet duke marrë leje nga mësuesi i laboratorit dhe nën kontrollin e tij.

RREGULLAT E INFERMIERISË DHE TË MJEKUT

1. Infermiera e shkollës qëndron e hapur në oraret e përcaktuara nga drejtoria.
2. Përkujdesja mjekësore bëhet në dhomat e mjekut. Nëse nevojitet ndërhyrje mjekësore, shkohet në klinikë.
3. Në infermieri ndodhen ilaçet dhe mjetet mjekësore për ndihmën e parë. Përveç kësaj, nxënësit, e kanë të ndaluar të mbajnë ilaçe. Nxënësit që përdorin ilaçe për raste të veçanta, duhet të bëjnë me dije për këtë drejtorinë dhe duhet të marrin leje prej saj.
4. Në rastet kur nxënësi infektohet nga ndonjë sëmundje serioze ose ngjitëse, lajmërohet familja e tij dhe mundësohet transporti deri në shtëpi.
5. Dosja shëndetësore e nxënësit është pjesë e procedurës së regjistrimit dhe pa dorëzimin e saj në shkollë kjo procedure nuk përfundon. Çdo fillim viti shkollor librezja shëndetësore e nxënësit rinovohet. Çdo ndryshim në shëndetin e fëmijës i tregohet shkollës dhe mjeku bën shënimet e duhura në dosjen e tij.
6. Sëmundjet e rëndësishme dhe të veçanta i tregohen mjekut të shkollës. Shkolla nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të kenë të sëmurët për të cilët nuk ka informacion (si epilepsi, sëmundje të zemrës etj.)
7. Personeli i shkollës, në raste urgjente me shëndetin ka të drejtën ta marrë nxënësin nga mësimi dhe pasi të bisedojë me prindin e dërgon në spital.
8. Ankesat në lidhje me shërbimet mjekësore mund të paraqiten me shkrim te zyra e drejtorit.

RREGULLAT E SALLËS SË KONFERENCAVE, MULTIMEDIAS DHE KINEMASË, KLASËS 3D, KLUBIT TË DRAMËS, KLASËS ME IPAD ETJ.

1. Nuk duhet dëmtuar sistemi multimedial i sallës së konferencave.
2. Nxënësit, të cilët zhvillojnë aktivitete në sallën e konferencave, në fund të programit duhet t'u dorëzojnë personave përgjegjës mjetet e përdorura. Në rast dëmi, zhdëmtimi kryhet nga nxënësit.
3. Në fund të programeve, karriget e sallës së konferencave duhen lënë të rregullta e të padëmtuara.
4. Në sallën e konferencave është e ndaluar të konsumohen ushqime apo pije.
5. Gjatë programeve, nxënësit s' duhet të shfaqin sjellje të pahijshme apo të flasin me zë të lartë.
6. Në aktivitetet e organizuara nga shkolla si konferenca, panele, seminare dhe debate nuk duhet të ketë sjellje të pahijshme (bërtitje, mungesë serioziteti dhe hyrje-dalje shqetësuese nga salla).
7. Të gjitha rregullat e shkollës janë të vlefshme edhe në sallën e konferencës.
8. Ankesat në lidhje me këto ambiente mund të paraqiten me shkrim te zyra e drejtorit.

RREGULLAT E VIZITORËVE

Procedura e pranimit të vizitorëve në mjediset e shkollës.

Hyrja e personave të huaj në institucion kryet nën shoqërimin e receptionistit ose sekretares së shkollës, pasi vihet në dijeni drejtoria. Gjithashtu janë hartuar disa rregulla për pranimin e vizitorëve në ambientet e shkollës.

1. Nuk pranohen vizitorë jashtë orarit të përcaktuar nga shkolla (08:00-16:00) si dhe jashtë orareve të takimeve prindër-mësues.

2. Vizitorët nuk mund të takohen me nxënës pa lejen e drejtorisë. Prindi s'mund të takohet me nxënës të tjerë përveç fëmijës së tij.

3. Vizitorët duhet të kenë patjetër mjet identifikues me vete.

4. Vizitori jep të dhënat e kërkuara dhe vendos kartën e vizitorit në një vend të dallueshëm gjatë vizitës në shkollë.

5. Kur shihet e arsyeshme nga drejtoria, mund të kontrollohen sendet që u sillen nxënësve.

6. Automjetet që sjellin nxënësit lejohet të hyjnë në oborrin e shkollës në mëngjes në orarin 07:00-09:00. Para orës 07:00 dhe mbas orës 09:00 (përveç rasteve të veçanta të lejuara nga Drejtoria) nuk do të lejohet hyrja e tyre. Në lidhje me rastet e veçanta të përmendura më lart, vizitorët duhet të kontaktojnë me:

- Drejtorin e shkollës
- Nëndrejtorin përkatës

7. Nëndrejtorët dhe mësuesit hyjnë në shkollë duke treguar një mjet identifikimi. Roja kontrollon nëse emri gjendet në listën e personelit. Nëse roja i njeh nuk u kërkon ID.

8. Për personat të cilët kërkojnë të hyjnë në shkollë si këmbësorë pas orës 08:00, do të aplikohet procedura e marrjes së kartës së identitetit dhe pas kësaj do të shoqërohen për te sekretaria e godinës përkatëse.

Procedura do të zhvillohet në këtë formë:

- Merret dokumenti i identifikimit të personit dhe i jepet karta e vizitorit.

- Personi që është i regjistruar mund të hyjë pa qenë nevoja të presë për ndonjë procedurë. Ai/ Ajo dorëzon kartën e identitetit.

- Personi që nuk është i regjistruar mund të hyjë pasi të jetë regjistruar në Regjistrin e Hyrjes dhe të jetë njoftuar sekretaria përkatëse prej së cilës merret me patjetër konfirmim.

i) Hyrja e automjeteve taksi të kontaktuara nga shkolla nuk do të lejohet pa marrë konfirmimin e duhur nga nëndrejtori përkatës.

ii) Nxënësit, të cilët nuk kanë fletën dalëse me firmë dhe me vulë të nëndrejtorit përkatës, nuk do të lejohen në asnjë mënyrë të dalin jashtë.

iii) Nuk do të lejohen të hyjnë në ambientet e shkollës pa njoftuar personat përgjegjës, asnjë furgon jo i shkollës ose persona të tjerë, qofshin të ftuar apo jo.

iv) Pas orës 15:30 do të lejohen automjetet për kopshtin (furgonat e shkollës ose mjetet private të prindërve).

9. Çdo hyrje e çdo personi, qoftë ai i regjistruar apo jo në listat që gjenden te roja, do të mbahet shënim në Regjistrin e Hyrjes Online prej orës 08:00 deri në 16:30. Pas orës 16:30 regjistrimi i personave që hyjnë në shkollë bëhet nga roja në një fletore të veçantë. Ditën pasardhëse roja i radhës i shton këta emra në Regjistrin e Hyrjes Online. Përrjashtohet nga procedura e regjistrimit të hyrjes secili personel i shkollës që gjendet në listat e rojes.

10. Roja e ka të ndaluar të pranojë brenda ambienteve të shkollës persona që paraqiten duke thënë se kanë takim me dikë brenda shkollës, qoftë edhe sikur të përmendet emri i nëndrejtorëve apo i drejtorit. Roja duhet të ndjekë procedurat normale siç përshkruhen në këtë dokument.

11. Në çdo rast, nëse vërehet diçka e pazakontë, roja kryen kontroll të mjetit ose fizik të personit dhe kërkon mjet identifikimi. Nëse rezulton në rregull, vijohet me procedurat normale si edhe përshkruhet në këtë dokument.

12. Gjatë ditës, asnjë nga personeli i shkollës nuk lejohet të hyjë me makinë në shkollë dhe nuk lejohet të parkojë makinën në ambientet e saj. Të shtunave para orës 14:00 asnjë nga personeli i shkollës nuk mund të hyjë me makinë në shkollë dhe nuk mund të parkojë në ambientet e saj.

13. Mjetet e personelit mund të parkohen brenda shkollës gjatë javës pas orës 16:00, të shtunave pas orës 14:00, dhe të dielave prej mëngjesit dhe gjithë natën, para furgonave të shkollës, me kusht që në mëngjesin e ditës pasardhëse të mos bëhen pengesë për qarkullimin e trafikut.

14. Mjetet që parkohen brenda shkollës në mënyrë të prerë nuk duhet të lihen pas mensës, pranë apo pas bllokut B, para zyrës së transportit, para kopshtit, pranë portave hyrëse dhe dalëse duke penguar qarkullimin.

15. Është e qartë se cila portë shërben për hyrje dhe cila për dalje nga shkolla. Midis orës 07:00 dhe 16:00 hyrja do të kryhet vetëm nga porta hyrëse dhe dalja do të kryhet vetëm nga porta dalëse. Mbas orës 16:00 mund të kalohet nga secila portë.

16. Nuk mund të sillen dhe të pranohen vizitorë, jashtë rregullave të përcaktuara nga drejtoria e shkollës.

17. Në rastet e urgjencave mjekësore, prindi komunikon me nëndrejtorin përkatës dhe pret t'i dorëzohet fëmija te hyrja ose te dalja e shkollës, pa e futur mjetin brenda. Mospranimi i mjetit në ambientet e shkollës bëhet për arsye sigurie.

RREGULLAT E SERVISIT

1. Nxënësit kryesisht përdorin transportin e shkollës, i cili varet nga Zyra e Transportit.
2. Për të përdorur transportin e shkollës prindërit e nxënësve bëjnë pagesën në momentin e regjistrimit. Kjo pagesë është e ndryshme dhe varet nga distanca shtëpi-shkollë.
3. Për nxënësit që nuk përdorin transportin e shkollës përgjegjësinë e transportit e mban prindi i fëmijës.
4. Transporti nuk mund të përdoret vetëm për vajtje në shkollë ose për kthim nga shkolla.
5. Të gjitha rregullat e shkollës janë të vlefshme edhe në mjetet e transportit (nuk mund të shfaqen sjellje të tjera kundër rregullave të shkollës; nuk lejohet mosrespektim i shoferit apo mësuesit shoqërues në furgon, nuk lejohet pirja e duhanit etj.).
6. Drejtoria e shkollës vendos t'i heqë të drejtën e përdorimit të transportit për një periudhë kohore të shkurtër ose të përhershme nxënësve që nuk zbatojnë rregullat në furgon.
7. Problematikat e shfaqura nga nxënësi gjatë vitit shkollor mund të sjellin përjashtimin nga shërbimi i transportit në vitin pasardhës.
8. Kërkesat dhe ankesat në lidhje me shërbimin e transportit administrohen nga Zyra e Transportit dhe çështjet jashtë mundësive të kësaj zyre i njoftohen nëndrejtorit përkatës.

Rregullat e transportit janë si më poshtë:

1. Mos shpërqendroni shoferin.
2. Veproni sipas paralajmërimeve të personit përgjegjës ose shoferit.
3. Nxënësit duhet të hipin në furgon në adresën e rënë dakord dhe të zbresin brenda shkollës.

4. Tregohuni të përpiktë në orarin e furgonit (në mëngjes dhe në përfundim të mësimit). Nëse nuk do e përdorni furgonin, njoftoni shoferin në mënyrë që të mos e lini të presë.
5. Mos u përpigni të hipni ose zbrisni nga furgoni ndërkohë që ai është në lëvizje.
6. Hipja dhe zbritja nga furgoni duhet të kryhet me radhë dhe rregull si dhe nëse lind nevoja, nxënësit të ndihmojnë njëri tjetrin.
7. Në furgon nuk qëndrohet në këmbë.
8. Mos u zgjasni jashtë dritares.
9. Mos hidhni mbeturina nga dritarja.
10. Mbajeni pastër furgonin dhe kujdesuni për të. Nëse ai dëmtohet, nxënësi përgjegjës për veprimin duhet të paguajë për dëmin. Nëse veprimi përsëritet, mund të merret masë me përjashtim nga furgoni.
11. Në furgon ndalohen mjetet elektronike. Nëse vërehen këto sende, do të merren nga përgjegjësit e furgonit ose shoferi, të cilët i dorëzojnë te nëndrejtori përkatës.
12. Duhet të jeni të sjellshëm me personin përgjegjës në furgon si dhe me shoferin.
13. Ndalohet çdo fjalë ofenduese si dhe çdo veprim i dhunshëm, qoftë ky fizik apo verbal.
14. Ndryshimet në adresën e shtëpisë duhet të njoftohen minimalisht një ditë para dhe nëse është e mundur do të realizohet kalimi në një furgon tjetër.
15. Sigurohuni që të mos harroni sendet tuaja në furgon.
16. Në çdo moment duhet mbajtur i vënë rripi i sigurimit. Në rast se merret gjobë për mosvënien e rripit, ajo paguhet nga ana e prindit.

Disiplina

DISIPLINA

1- Zbatimi i pikëve të sjelljes dhe sjelljet që këkojnë marrje masash

Veprimet dhe sjelljet e pahijshme që thyejnë rregulloren në ambientet e shkollës e që kryhen nga nxënësit, do të shënohen nga mësuesit si ulje pikësh nga pikët e sjelljes së nxënësve. Nxënësit që tejkalojnë 10 pikë dërgohen në Komisionin e Etikës dhe Sjelljes ku bëhet këshillimi i tyre dhe si masë ndëshkimore mund të meret qortim ose dënime të tjera të lehta. Për këtë njoftohen prindërit. Nxënësit që tejkalojnë 20 pikë në shkelje rregulloreje do të shqyrtohen në Komisionin e Disiplinës me miratimin e drejtorisë. Gjithashtu për pjesëmarrjen e këtyre nxënësve në aktivitetet jashtëshkollore vendos drejtoria. Për sjelljet e paparashikuara në listën e mëposhtme vendos Drejtoria përkatës ose Komisioni i Disiplinës.

A- Sjelljet dhe pikët në ambientet e shkollës

Sjelljet	Pikët
Zhurma në mësim dhe prishja e harmonisë së klasës	2
Ndërrimi pa leje i vendit në klasë	2
Ngrënia ose përtypja e diçkaje në orë të mësimi	2
Mungesa e mjeteve mësimore në mënyrë të vazhdueshme	2
Moskryerja e përsëritur e detyrave	2
Vrapimi në korridor dhe zhurma	2
Prishja e radhës në mensë	2
Hyrja pa leje në mësim	2
Përdorimi i veshjeve shtesë jo të uniformës duke mbuluar uniformën	2
Lyerja e flokëve me ngjyra të ndryshme dhe me xhel	2
Mosmbajtja e uniformës në ambientet e shkollës	4
Deformimi i papërshtatshëm i uniformës	4

Mbajtja e bizhuve ekstravagante, makijazhi dhe pirsing	4
Hyrja me vonesë e përsëritur në klasë	4
Prishja e rregullit në shkollë, korridor, mensë, oborr dhe ndotja e ambienteve	4
Ndërrimi i vendeve të sendeve të shkollës pa leje	4
Hedhja nga dritarja e letrave, mbeturinave, sendeve të tjera	4
Vonesa në orarin e servisit	4
Fjalë të pahijshme dhe ofenduese	4
Mbajtja e materialeve për/luajtja bixhoz dhe lojëra shansi	5
Mbajtja në shkollë e celularëve, ora, smartwatch dhe mjete të tjera elektronike	5
Mungesa pa leje në mbledhjet e nxënësve	5
Sjellje pa seriozitet gjatë këndimit të himnit kombëtar	5
Marrja ose përdorimi pa leje i sendeve të tjetërkujt	5
Gënjeshtër dhe mashtrimi	5
Sjellje të pahijshme ndaj personelit	5
Marrja dhe moskthimi i librave ose dokumenteve që i përkasin shkollës	5
Mosparaqitja në provim pa justifikim ose raport mjekësor	5
Shfaqja e sjelljeve të pahijshme që prishin rregullin në furgon	5
Dëmtimi i sendeve të shkollës	10
Mosparaqitja në mësim pa leje	10
Sjellje e pahijshme kundrejt normave morale	10
Dëmtimi i afisheve të varura nga drejtoria e shkollës	10
Mbajtja e sendeve dëmtuese dhe prerëse	10
Zënka mes dy vetësh, pa të plagosur	10
Mosdorëzimi i dokumenteve që shkolla u dërgon prindërve	10
Largimi pa leje nga klasa gjatë mësimi	10
Kopjimi nga të tjerët dhe dhënia e kopjes	10
Nxitja e nxënësve për konflikt.	10
Varja e afisheve dhe shpërndarja e lajmërimeve pa leje nga drejtoria	20
Sjellje e pahijshme ndaj mësuesit	20
Ofendimi i personelit	20
Largimi pa leje nga shkolla	20
Organizimi i festave apo shëtitjeve pa lejen e drejtorisë	20

Zënka mes dy vetësh, me plagosje	20
Kërcënim me lëndë prerëse ose dëmtuese	20
Kërcënimi i mësuesit dhe personelit	20
Zënka në grupe të organizuara	20
Mbajtja ose konsumimi i duhanit në shkollë ose në servis	20
Hyrja në tualet tjetër nga ata të përcaktuar për të	20
Shfaqja e sjelljeve amorale që mund të jenë shembull i keq për të tjerët	20
Ndryshimi (psh. falsifikimi) i çfarëdolloj dokumenti të përgatitur nga shkolla	20
Mbajtja dhe shfaqja e sendeve amorale në shkollë si gazetë, foto, revistë, kasetë, CD, etj.	20
Kopjim duke përdorur forcën dhe kërcënimin	20
Sjellje e pahijshme ndaj flamurit shqiptar apo të shteteve të tjerë	20
Vjedhje e organizuar	20
Shfaqja e sjelljeve penguese për punën e drejtorisë, mësuesve, personelit	20
Pengimi në hyrje në shkollë, mësim apo provim, ose pengim në realizimin e mësimit ose të provimit dhe nxitje apo detyrim me force i të tjerëve për të dalë nga mësimi	20
Luajtja me lojëra bixhozi dhe nxitja e të tjerëve	20
Frikësimi dhe kërcënim i nxënësve të tjerë ose kërkimi i parave me forcë.	20

B- Sjelljet dhe pikët në furgon

Sjelljet	Pikët
Të ngelesh vonë në mëngjes. Të lësh në pritje furgonin e shkollës	2
Të bësh pis automjetin	2

Të qëndrosh në këmbë ndërsa automjeti është në lëvizje	5
Të nxjerrësh dorën, krahun, kokën etj. nga dritarja	5
Të mos vendosësh rripin e sigurimit	5
Të hedhësh diçka, të pështysh nga dritarja e automjetit etj	5
Të bezdisësh shokët me fjalë (ofendim, fyerje etj.)	8
Të dëmtosh automjetin	10
Të mbash telefon në furgon	10
Të bezdisësh mësuesin, shoferin me fjalë (ofendim, fyerje etj.)	12
Të bezdisësh fizikisht shokët (me duar, duke qëlluar etj.)	12
Të bezdisësh fizikisht mësuesin ose shoferin (me duar, duke qëlluar etj.)	12
Të kërcënosh të pranishmit në furgon	15
Të përpiqesh të hipësh ose të zbresësh pa ndaluar automjeti. (Të vësh në rrezik jetën)	15
Të zihesh në furgon	20
Të hyjë në furgon një familjar i ndonjë nxënësi dhe të ndërhyjë tek nxënësit tjerë, fizikisht ose me fjalë	20
Të mos shkosh në vendin e caktuar pasi ke zbritur nga furgoni (shtëpi, ose vendin ku është përcaktuar)	20
Të zbresësh nga automjeti në një vend që nuk duhet zbritur	20

2- Mënyra e veprimit në raste të shkeljes së disiplinës

Vendimi i marrë nis zbatimin pas miratimit nga drejtori i shkollës. Para se të jepet vendimi për nxënësin, Komisioni i Disiplinës mban parasysh gjendjet e poshtëshënuara:

1. Lloji dhe shkalla e gabimit të kryer nga nxënësi
2. Gjendja e sjelljeve deri në atë ditë dhe nota e tyre
3. Ankesat e të tjerëve
4. Letra mbrojtëse e nxënësit

5. Opinioni i mësuesit kujdestar
6. Opinioni i nëndrejtorit përkatës
7. Mënyra e sjelljes së nxënësit teksa flet përpara komisionit
8. Opinioni i familjes së nxënësit

Llojet e ndëshkimve që mund të japë komisioni i disiplinës

A. Masat disiplinore për nxënësit sipas dispozitave normative:

- a. Qortim
- b. Vërejtje
- c. Paralajmërim për ulje të notës së sjelljes
- d. Ulje me një shkallë e vlerësimit të sjelljes
- e. Vlerësim “Dobët” i sjelljes

Krahas masave disiplinore për nxënësin të parashikuara në Nenin 107 të D.N komisioni parashikon dhe disa masa të tjera si ç’janë këto:

	<u>Pikët</u>
Paralajmërim me gojë	0
Vërejtje (paralajmërim me shkrim pa pikë)	0
Paralajmërim me shkrim me pikë	3-12
Përfjashtim i përkohshëm	9-20
Përfjashtim me dokument nga shkolla	40

Nxënësve të cilëve nota e sjelljes u bie nën 60 për shkak të ndëshkimeve që marrin nga komisioni i disiplinës, përfjashtohen nga shkolla me vendim të Komisionit të Disiplinës dhe Drejtorisë së shkollës.

Çështjet që meren parasysh gjatë ndëshkimit

Kur jepen ndëshkimet e disiplinës mbahen parasysh këto çështje:

- a) Veçoritë individuale të nxënësit
- b) Cilësia e sjelljes, rëndësia dhe në ç’kushte është kryer ajo

- c) Gjendja psikologjike e nxënësit në momentin e sjelljes
- d) Gjendja e përgjithshme e nxënësit brenda dhe jashtë shkollës
- e) Sukseset dhe interesi i nxënësit në mësimet
- f) Nëse nxënësi ka marrë ndëshkim më parë brenda të njëjtit viti mësimor
- g) Nuk merret parasysh i gjithë personaliteti i nxënësit, por vetëm sjellja në fjalë

Bazat në lidhje me zbatimin

Në zbatimin e ndëshkimit mbahen parasysh çështjet e mëposhtme:

- a) Në zbatimin e ndëshkimit me përjashtim të përkohshëm;
 1. Mosmarrja pjesë në mësimet nuk konsiderohet përjashtim i përkohshëm nga shkolla.
 2. Gjatë kësaj kohe nxënësi nuk mund të hyjë në provime.
 3. Nxënësit që përjashtohen përkohësisht nga shkolla, në rast se janë me “zbritje”, mund të privohen prej saj.
- b) Në rastet kur nxënësi përjashtohet nga shkolla me dokument, ai shpëputet të gjitha marrëdhëniet zyrtare me shkollën dhe nuk ka asnjë të drejtë mbi të.
- c) Thyerjet e disiplinës dhe ndëshkimet duhet të jenë të përputhshme.
- d) Ndëshkimet jepen vetëm nga “Komisioni i Disiplinës”.
- e) Drejtori i shkollës, në rast nevojë, mund t’i japë drejtpërdrejtë nxënësit “Paralajmërim”.
- f) Ndëshkimet e dhëna nga Komisioni i Disiplinës futen në dosjen e nxënësve dhe shfaqen në transkriptin e tij. Ndëshkimet nuk shtyhen.

g) Ndëshkimet u jepen nxënësve nga ana e drejtorit apo komisionit të disiplinës duke u thënë fjalët e nevojshme edukative.

h) Nxënësit e olimpiadave që marrin ndëshkim disiplinor mund të privohen nga vijueshmëria e olimpiadave.

i) Për të gjitha ndëshkimet disiplinore që u jepen nxënësve lajmërohen familjet.

j) Nëse nxënësit marrin notë ndëshkimore disiplinore, brenda javës nga data e dhënies së ndëshkimit, duhet të takohen prindërit e tij nga komisioni i disiplinës ose përfaqësues të drejtorisë së shkollës.

k) Nëse nxënësi përsërit të njëjtin gabim qëllimisht disa herë, atëherë komisioni disiplinor mblidhet për t'i dhënë një tjetër ndëshkim nga ai i parashikuar për të penguar përsëritjen.

l) Nxënësit që e kanë notën disiplinore më të ulët se 90 pikë nuk marrin pjesë në aktivitetet e organizuara nga shkolla.

m) Për gabimet e papërcaktuara në listën e komisionit të disiplinës, komisioni disiplinor mund të përcaktojë ndëshkimin e duhur.

n) Nxënësi i cili nuk e ka notën e disiplinës 100 nuk merr Fletë Nderi dhe Falenderimi.

o) Nxënësi që nuk e ka notën e disiplinës 100 nuk përfiton zbritje për vitin pasardhës.

RREGULLAT E PRANIMIT DHE REGJISTRIMIT PRANË SHKOLLËS “TURGUT ÖZAL”

Faza e Parë

Aplikantët marrin një informacion të detajuar mbi arsimimin, metodat e reja që aplikohen, ambientet komode dhe çdo gjë tjetër që ofron shkolla për një arsimim sa më bashkëkohor dhe efikas. Më pas, fëmija i nënshtrohet një testi, i cili zhvillohet me anë të kompjuterit.

Testi i pranimi për klasat e para përfshin njohuritë bazë që duhet të kenë fëmijët e kësaj moshe; për klasat e 2-ta maten njohuritë në dy lëndë: matematikë dhe gjuhë shqipe; ndërsa për klasat e 3-ta deri në të 9-ta maten njohuritë në tre lëndë: matematikë, gjuhë shqipe dhe anglisht. Të gjithë aplikantët, nga klasa e parë deri në klasën e nëntë, pasi hyjnë në testin e pranimi, i cili është i detyrueshëm, duhet të arrijnë pikët e nevojshme të përcaktuara më parë nga drejtoria e shkollës për të vazhduar me fazën e dytë të regjistrimit.

Faza e dytë

Pas mbarimit të provimit, faza e dytë është kalimi pranë komisionit përkatës. Ky komision bën vlerësimin e rezultatit të provimit dhe është transparent. Aplikanti zhvillon një intervistë me komisionin, i cili më pas merr vendimin për pranimin ose jo të nxënësit, duke u bazuar te pikët që ai ka marrë në test.

Faza e tretë

Faza e tretë mbas pranimi është regjistrimi në shkollë dhe firmosja e një kontrate me kusht. Kjo kontratë është e lidhur me performancën në rritje që duhet të tregojë nxënësi gjatë vitit shkollor dhe shfaqjen e një sjelljeje në përputhje me rregullat e sjelljes dhe disiplinës.

Ankesat në lidhje me procedurën e pranimit në shkollë i jepen me shkrim drejtorit.

Dokumentacioni që nevojitet pasi është marrë përgjigje pozitive nga komisioni është si më poshtë vijon:

Kopshti

Certifikatë personale
Fotografi (2 copë)
Kartela e vaksinave
Koprokultur

Klasat 2-9

Certifikatë personale
Fotografi (2 copë)
Kartela e vaksinave
Dëftesë ose listë notash

Parashkollor

Certifikatë personale
Fotografi (2 copë)
Kartela e vaksinave
Koprokultur

Klasa e parë

Certifikatë personale
Fotografi (2 copë)
Kartela e vaksinave
Raport nga okulisti

VEPRIMTARITË E PARASHIKUARA NË KALENDARIN AKADEMIK

TETOR

Përmbledhje e aktiviteteve të sezonit

Konkursi i këngës, poezisë, kompozicionit dhe vizatimit

Muaji i letërsisë

Panairi i librit

Përzgjedhjet e lojrave të inteligjencës

Oxford placement test

Përcaktimi i grupeve të ASEF-it

Përzgjedhjet e olimpiadave

Kampionatet sportive

Fillimi i klubeve

Konkursi i folklorit

Përzgjedhja e anëtarëve të Klubit Shpresa dhe organizimi i panairëve

Takimi me prindër 1

NËNTOR

Shëtitja e grupeve të olimpiadave në Shqipëri dhe në Ballkan

Finalja e këngës, poezisë, kompozicionit dhe vizatimit

Java e historisë dhe gjeografisë

Provimi KET (klasa 6)

Kampionatet sportive

Festat e 28-29 Nëntorit

Finalja e përzgjedhjes së solistëve dhe folklorit, ndarja e çmimeve

Veprimtaritë humanitare të Klubit Shpresa

DHJETOR

Shëtitje në Ballkan

Shkolla dimërore në Londër

Vijimi i përgatitjes së grupeve të olimpiadave

Veprimtaritë humanitare të Klubit Shpresa
Vizita në shtëpitë e nxënësve

JANAR

Shëtitje në Ballkan
Lojrat e inteligjencës
Vijimi i përgatitjes së grupeve të olimpiadave
Veprimtaritë humanitare të Klubit Shpresa
Takim me prindër 2

SHKURT

Shëtitje në Ballkan
Java e matematikës
Finalja e ASEF-it
Vijimi i përgatitjes së grupeve të olimpiadave
Regjistrimi në klube për periudhën e dytë
Veprimtaritë humanitare të Klubit Shpresa

MARS

Shëtitje në Evropë
Java e anglishtes dhe provimi PET
Vijimi i përgatitjes për olimpiada
Kampionatet sportive
Festat e 7-8 marsit
Veprimtaritë humanitare të Klubit Shpresa

PRILL

Shëtitje brenda vendit dhe në Ballkan
Piknik (kopshti)
Oxford Placement Test 2
Përzgjedhja e finalistëve të olimpiadave
Përgatitjet për festat e klasave
Takim me prindër 3

MAJ

Shëtitje brenda vendit

Piknik

Provimi i pranimit

Provimet e olimpiadës shkencore

Festat e klasave

QERSHOR

Shëtitje brenda vendit

Shkolla verore (në shkollë dhe jashtë shtetit)

Piknik

Provimet e lirimit (klasat 5 dhe 9)

KLUBET QË DO TË ZHVILLOHEN GJATË VITIT AKADEMIK:

- | | |
|-------------------------------|------------------------|
| 1. Klubi Shpresa | 10. Klubi i fitnesit |
| 2. Klubi i medias | 11. Klubi i gatimit |
| 3. Klubi i folklorit | 12. Klubi i pianos |
| 4. Klubi i dansit dhe baletit | 13. Klubi i violinës |
| 5. Klubi i solistëve | 14. Klubi i kitarës |
| 6. Klubi i futbollit | 15. Klubi i vizatimit |
| 7. Klubi i volejbollit | 16. Klubi i ebrusë |
| 8. Klubi i basketbollit | 17. Klubi i kinemasë |
| 9. Klubi i karatesë | 18. Klubi i alpinizmit |

PËRGATITJET PËR OLIMPIADAT QË DO TË ZHVILLOHEN GJATË VITIT AKADEMIK:

1. Matematikë
2. Gjuhë angleze
3. Fizikë
4. Kimi
5. Biologji
6. Informatikë
7. Gjuhë turke

SHËTITJET QË DO TË ZHVILLOHEN GJATË VITIT AKADEMIK:

Krujë
Shkodër
Vlorë
Durrës
Tiranë
Kosovë
Maqedoni

Shkollë verore në Nju Jork
Shkollë verore në Londër
Shkollë dimërore në Londër
Evropë
Kroaci
Mali i zi
Bosnje

DISA PROVIME TË RËNDËSISHME QË DO TË
ZHVILLOHEN GJATË VITIT AKADEMIK:

KET, PET

Young learners placement test

Oxford placement test

Webquiz-e në lëndë të ndryshme

ërdorim teknologjinë më shumë në

Le ta përdorim teknologjinë



Përgatitemi për jetën

